

MIMOZA PRIKU

RRETH DISA NDËRTIMEVE E KUPTIMEVE TË PASKAJORES NË PROZËN E MARTIN CAMAJT

Hyrje

Studimet me karakter linguistik shpeshherë kanë bërë objekt shqyrtimesh gjuhën e shkrimtarëve të ndryshëm, si N. Frashëri, F. Noli, J. Xoxa dhe pas viteve '90 kjo radhë është pasuruar me emrat e Konicës, Fishtës, Camajt etj. Kontributi i këtyre shkrimtarëve është parë e vlerësuar edhe në aspektin gjuhësor, pasi përdorimi i shqipes në stilin letraro-artistik i ka sjellë asaj pasurim, zgjerim, variacion e shpesh ngulitje e ngritje deri në normë të mjaft fjalëve e formave gjuhësore. Gjuhëtari i njohur A. Xhuvani, duke njohur rëndësinë e krijuesve me të drejtë theksonte se “*në çdo kohë shkrimtarët kanë qenë ata që i kanë dhënë hov përparimi gjuhës me veprat e tyre tue lavrue e tue pasunue*”¹. Pjesë e kësaj pasurie është, padyshim, edhe vepra letrare e shkrimtarit Martin Camaj, ndihmesë e cila kërkon studim e vlerësim në shumë aspekte. Vëmendja jonë në këtë punim është përqendruar kryesisht në shqyrtimin e disa përdorimeve dhe kuptimeve të paskajores, vjelë kryesisht nga proza e Camajt. Le t’i shohim disa prej tyre.

1. Tipat e ndërtimit të paskajores

Paskajorja njihet si një formë foljore, e cila kryesisht “shënon veprimin në një mënyrë shumë të përgjithshme e të paaktualizuar me tregues gramatikorë që janë karakteristike për foljen”².

Veçori e prozës së Camajt është se ky shkrimtar, megjithëse nga trevat veriore, nuk është kufizuar vetëm në përdorimin e formave e trajtave të gegërishtes, por ka kaluar përtej këtyre caqeve. Për rrjedhojë, ai nuk ka përdorur vetëm paskajoren geqe, por tre tipa të paskajores, tipin *me punue*,

¹ A. Xhuvani, “Detyrat e shkrimtarëve të rinj për gjuhën shqipe”, *Vepra 1*, Tiranë, 1980, f. 31.

² S. Mansaku, “Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë, 1982, f. 144.

për të punue e më rrallë për me punue³. Pjesën më të madhe të këtyre ndërtimeve në mënyrë të natyrshme e zë paskajorja e tipit *me punue*, e ndërtuar nga pjesa me origjinë parafjalore *me +pjesore*, si *me jetue*, *me hy*, *me kthye* etj. Shembujt në prozën e Camajt nuk mungojnë mes të cilëve veçojmë:

“...ia vlefti **me kundrue** çka pau...” (Drandja, f. 50); “...po të ishte punë që bahej **me çue** zanin...” (Rrathë, f. 194); “...tue shtrëngue herë mbas here tamthat e kresë, si **me dashtë me shtrydhë** trutë...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 95); “...mund të ngrihej aq nalt sa **me sundue** mbi Karpë...” (Karpa, f. 107) etj.

Shpeshherë kjo paskajore del e paraprirë nga lidhëza *as*, si:

“...tha tue çue zanin, **as me qenë** tue folë para një turme..” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 120); “...rrëzoheshin deri te rana buzë detit **as me qenë** breshka dhi që ndjek çubet...” (Drandja, f. 53); “...secili e ndiente se nuk duhej prishë heshtja, **as me qenë** kjo normë rituale e stërlashtë..” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 94) etj.

Kjo formë foljore është e pranishme shpesh në shprehje e njësi frazeologjike, si *me pritë e me qitë*, *me shkue e me u mbytë në lumë*, si *me e pasë përpi dheu* etj.

Një tjetër ndërtim i paskajores përdorur nga Camaj është ai tipit *për të punue* në rastet, si *për të ndëgjue*, *për të hypë*, *për të nxjerrë*, *për të dalë*, *për të zbërthye*, *për të krijue*, *për të prekë* etj. Le ta konkretizojmë me shembuj nga proza e këtij shkrimtari:

“...tue pritë të zotin e ndërtesë së vjetër **për të nënshkrue** kontratën e shitjes...” (Drandja, f. 55); “...nuk e lodhte mendën **për ta qietë** shkaku...” (Karpa, f. 18); “...mbyllnin papritmas gojën **për të ndëgjue** nga bashkëfolësi ngjarjet e sprasme...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 110) etj.

Mund të veçojmë këtu ndonjë rast kur kjo formë foljore ka kuptim mohor, ku zakonisht do të prisnim një folje në lidhore, ndërsa tek Camaj gjejmë *për të + mos + pjesore* p.sh. “...ngulte këmbë **për të mos nisej** të nesërmen për fis...” (Karpa, f. 6) (do të prisnim konstruktin *të mos nisej*).

Një ndërtim interesant është edhe *për + paskajore* e tipit *me punue* në rastet kur paskajorja e gegërishtes “për të dalluar më mirë ndonjë funksion sintaksor të paskajores merr ndonjëherë para pjesës *me* parafjalën *për*,

³ Nga shqyrtimet e bëra nga gjuhëtari M. Gero, rezulton se përdorimi i lidhore në prozën e Camajt krahasuar me paskajoren e forma të tjera foljore, rezulton me një denduri më të madhe se të gjitha të tjerat, më pas vjen paskajorja e tipit *me punue*.

Rreth disa ndërtimeve e kuptimeve të paskajores në prozën e Camajt

duke krijuar kështu një formë të re të tipit *për me punue*⁴. Ndërtimin për+me+pjesore F. Altimari e ka evidentuar edhe tek shkrimtarët arbëreshë “jo se janë ndikuar nga shkrimtarët gegë, por sepse kanë përdorur në veprat e tyre trajta të ruajtura në arbërishten e gjallë të kohës”⁵ dhe, po sipas këtij studiuesi, ka të folme që vazhdojnë ta ruajnë këtë tip infiniti, si *për me ngrën*, *për me pir* etj.

Në prozën e Camajt ndeshet kjo formë kryesisht në ndërtime mohore, si: “...çka kam hjekë të tanë jetën **për mos me ju lanë** të merrni shtigjet...” (“Pishtarët e natës”, Vepra 4, f. 23); “...u largue me qëllim **për mos me hy** në kuvendime të gjata...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 16); “...mbajti gojën **për mos me tregue** acarim...” (Rrathë, 252); (...“i sillnin kuvendin ndryshe **për mos me i dhanë** shkas...” (Rrathë, 81) etj.

1.1. Forma joveprore e paskajores

Formën joveprore të dy tipat e paskajores e formojnë me anë të formantit *u*, kur bëhet fjalë për të ashtuquajturën të tashmen e paskajores dhe me anë të foljes ndihmëse *jam* për të kryerën. Në ndërtimet e thjeshta kemi rastet:

“...fat për ty **me u gjetë** në një vend të caktuem...” (Karpa, f. 11); “...grindeshim me këmishën e vume **me u terë** mes xhamave...” (Drandja, f. 76); “...sa djem e vjaza lejoheshin me hy në këtë vend **për t’u martue**...” (Karpa, f. 6) etj.

Karakteristikë e stilit të Camajt është përdorimi dhe bashkërendimi i formave të ndryshme foljore e, meqë flasim për paskajoren, përmendim aftësinë e tij jo thjesht për t’i përdorur njëkohësisht dy tipat e ndryshëm të paskajores, por për t’i harmonizuar ato në shembujt, si “..si **me kafshue** diçka **për ta qëllitë** mandej befas...” (Karpa, f. 7); “...pa qenë e zonja **me qërrye** cipën e dheut **për t’i celë** vorrin vetes...” (Drandja, f. 72); “...që të kullohet si loti i synit **për të qenë** i denjë **me jetue** ndër ju...” (Karpa, f. 12) etj.

1.2. Ndërtimet e përbëra të paskajores

Gegërishtja, përveç paskajores së thjeshtë të tipit *me punue*, përdor dëndur edhe forma të përbëra të saj. Këtë tipar e mishëron shpeshherë

⁴ S. Mansaku, “Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë, 1982, f. 140.

⁵ F. Altimari, “Selman Riza dhe çështja e paskajores” në *Studime shqiptare* 17, f. 22.

proza e Camajt dhe jo vetëm në këtë formë foljore, por edhe në ndërtime të përbëra e të mbipërbëra të mënyrës dëftore, habitore etj.⁶, p.sh.:

“...rri shtang përpara një lulje livadhi sikur **me pasë harrue** me marrë frymë...” (Drandja, f. 65); “...më duket njënjë sikur **me pasë kthye** nja treqind vjet prapë...” (Karpa, f. 12); “...si **me u pasë kujtue** se një ankim i tillë nuk ishte për burra...” (Rrathë, f. 259); “...si **me pasë qenë ndreqë** prej të parëve...” (Karpa, f. 38) etj.

2. Ndërtimet kam+paskajore

Sipas gramatikës së shqipes, një nga nëntipat e së ardhmes dhe së ardhmes të së shkuarës, ndërtohet duke i paravendosur formës së pashtjelluar të tipit *për të larë* (me *punue* për gegërishten), format vetore të kohës së tashme e përkatësisht të pakryer të foljes ndihmëse *ka*⁷. Kështu, shqipja përdor tre nëntipa për të formuar të ardhmen, të parapirra këto nga folja *kam*: *kam+paskajoren* e tipit *me ba* (*kam+me ba*); nëntipi i dytë *kam+paskajoren* e tipit *për të bërë* (*kam+për të bërë*) dhe nëntipi tjetër *kam+lidhore të bëj*⁸. Lidhur me këto forma, F. Altimari shënon se gegërishtja, e cila ruan akoma infinitivin aktiv në hapësirën ballkanike, gjithmonë si një “futurum necessitates”, ka përshatur një ndërtim analog me atë të arbërishtes⁹. Kështu, ndërtimit *kam+ infinitin gegë* (*kam me punue*) në arbërisht i përgjigjet *kam të bënj* apo edhe *kam bënj*.

Megjithëse Camaj për të ndërtuar kohën e ardhme përdor mjaft dendur formën *do të punoj*, për variacion hasen edhe ndërtimet *kam/kisha me punue* dhe *kam/kisha për të punue*.

Paskajoret e parapirra nga folja *kam*, në forma veprore, joveprore, por edhe të shoqëruara me pjesëza mohore, si *ka për të njoftue*, *kisha me ba*, *ka për harrue* e gjallërojnë mjaft prozën e këtij shkrimtari, p.sh., “...**ka për t’u dashtë** të mësohesh me thanë për vendlindjen...” (Karpa, f. 10); “**Ke për të ndjekë** luginën në anën e djathtë të majes...” (“Gjon Gazulli”, Vepra 4, f. 248); “...Unë s’**kisha me e lanë** kurrë vendin!” (“Pishtarët e natës”, Vepra

⁶ P.sh. “...dheu i Karpës **paska qenë plehnue** me gjithfarë “pluhdash”...” (Karpa, f. 13), “...nga moskuptimi gjuhësor **paskan qenë ba** gabime dikur...”, (Rrathë, f. 227) “...mbasi **e paske pasë vendosë** të gënjesht, lexuesit i mbetet...” (Karpa, f. 15) etj.

⁷ Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f. 290-291.

⁸ E. Likaj, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997.

⁹ F. Altimari, “Il “futuro necessitativo” dell’albanese d’Italia”, në *L’influsso dell’italiano sulla grammatica delle lingue minoritarie*, Atti del Convegno Internazionale, Costanza, 8-11 ottobre, 2003, f. 5.

4, f. 22); “...sot nuk **kisha me e përdorë**...as për të shënue një barnatar...” (Karpa, f. 11) etj.

Ndërtimet *kam për të bërë e kishte për të bërë* janë të veshura me nuanca të ndryshme modale, prandaj dhe gjuhëtari M. Çeliku i quan e ardhmja e sigurisë dhe e ardhmja e së shkuarës së sigurisë, duke qenë se ato mbartin ngjyrimin modal të sigurisë, por edhe të nevojës në disa raste¹⁰.

Camaj si letrar e gjuhëtar di të ndërkëmbejë bukur ndërtimet foljore të së ardhmes, duke luajtur edhe me nuanca modale, si në shembullin:

“...**ke për të qenë** e para që **do të ketë** të çame kreje...” (Karpa, f. 36)

3. Ndërtimet folje ndihmëse apo aspektive + paskajore

Gjuhëtarët Savoia-Manzini, në një punim të tyre, duke diskutuar për përndarjen e ndërtimit *me+pjesore*, shprehen se ky ndërtim “shfaqet në kontekste tipikisht të lidhura me paskajoren në gjuhë si italishtja, pra në kontekste me folje modale, shkakore, aspektore”¹¹.

Të dy tipat e paskajores tek Camaj gjenden të paraprirë nga folje gjysmëndihmëse me vlerë modale, kryesisht me kuptimin e domosdoshmërisë apo edhe të mundësisë, me një larmi kuptimesh kohore, por edhe modale. Këto folje mund të dalin me vlerën e kohës së tashme të mënyrës dëftore “**duhet me pasë** duresë me ato që nuk kuptojnë...” (Rrathë, f. 91), por edhe të së pakryerës së kësaj mënyre, si *mundej me hy*, *mundej me zbulue*. Shënojmë për këtë rast shembujt “...**mundej me u pritë** hovin...” (Rrathë, 114); “...**duhej me u mbarsë** me farna...” (Drandja, f.) etj.

Në mjaft raste ky modalitet shoqërohet me forma të mohores *nuk duhej me folë*, *nuk duhej me ikë* etj.

Paskajoret mund të paraprihen edhe nga foljet që tregojnë mënyrën e veprimit, si fillim, vazhdim e përfundim i veprimit. Tek proza e Camajt me shumë larmi përdoren ndërtimet me folje që tregojnë *fillimin e veprimit +paskajoren me punue*. Me një denduri relativisht të lartë përdoret folja *mori*, në format *mori me shpjegue*, *mori me folë*, *mori me urrye*, *mori me zbulue*, *morën me tregue*; por ajo nuk është e vetmja që shënon këtë nuacë kuptimore. Kjo folje, bashkë me foljen *vë* ‘krahas mënyrës së fillimit të

¹⁰ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006, f. 231.

¹¹ R. M. Manzini-L. M. Savoia, “Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës”, *Studime filologjike*, nr. 3-4, 2003, f. 102.

veprimi, përmbajnë edhe idenë e intensitetit të veprimi, pra shprehin një fillim intensiv të tij¹². Këtë gjë e vërtetojnë edhe shembujt në vijim:

“...koha është letër e bardhë, thotë një fjalë e urtë në Karpë, - **mori me arsyetue** Shkriba...” (Karpa, f. 9); “...**nisën me u zhdërvillue** nga landa amorse...” (Karpa, f. 26); “...**nisi me bulue** bima e ndërgjegjes së breme...” (Drandja, f. 97); “...**nisi me u ndëgjue** mes zanave...” ; “...**u vu me ecë** në një hap me tjerë...” (Rrathë, f. 81); “...njerëzit **kishin fillue me dalë** në sheshe dhe qëndronin gjatë...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 94) etj.

Me vlerën modale të detyrimit gjendet edhe ndërtimi *jam*+paskajoren e tipit për të bërë, si: “...**ishte për t’i sha** vendit rrazë murit...” (Rrathë, f. 197); “...s **asht për t’u varë** ty torba...” (Rrathë, f. 191) etj.

Shpesh Camaj parapëlqen paskajoren më shumë se ndërtimet në lidhore në raste të tilla, si: “...**mateshin para se me folë**...” (“Karpa, f. 25) e jo para se të flitinin.

Për sa i takon kuptimit kohor, është pohuar se tek paskajorja ai “është mjaft relativ”¹³. Kuptimi kohor varet shumë edhe nga kuptimi leksikor i foljes drejtuese, si i së tashmes, p.sh., “...**duket si me qenë** të shkyeme teshash...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 101). Por kjo nuacë kuptimore mund të përforcohet edhe nga ndonjë ndajfolje kohore, si “...**tash dashkan me i ndreqë**...” (“Shkundullima”, Vepra 4, f. 103); kuptimi kohor i së ardhmes “...e bija **përgatitej me dalë** nuse...” (“Pishtarët e natës”, Vepra 4, f. 16) që shënon atë që pritet të kryhet në të ardhmen.

Për të dhënë nuaca të tjera kuptimore “shërbejnë edhe rrethanorët e ndryshëm ndajfoljorë, si *vijimisht, vazhdimisht, gjithmonë, pa pushim, pa ndërprerje*”¹⁴, duke përforcuar kështu idenë e vijëmesisë së veprimi, si “...ha e pi me popull se kështu **kanë me të dashtë gjithmonë**...” (Rrathë, f. 141); “...sa të kesh fshi lotët, ke për t’u **zhdukë, ke me marrë malin si dhi e egër gjithditën**, ashtu si çdo vjetë!...” (“Rrunga në mars”, Vepra 4, f. 170) etj.

Si përfundim, mund të themi se M. Camaj në të gjithë krijimtarinë e tij, por sidomos në prozë, ka përdorur një larmi ndërtimesh të paskajores, si në tipat e saj, por edhe në ndërtime me këtë bazë foljore duke na dhënë shembullin e një gjuhëtari të mirë e të një shkrimtari të talentuar, të një

¹² A. Dhrimo, “Mënyrat e veprimi foljor në gjuhën shqipe”, *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Tiranë, 2008, f. 373.

¹³ S. Mansaku, “Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë, 1982, f. 156.

¹⁴ A. Dhrimo, “Mënyrat e veprimi foljor në gjuhën shqipe”, *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Tiranë, 2008, f. 344.

Rreth disa ndërtimeve e kuptimeve të paskajores në prozën e Camajt

shkrimtari verior që diti të shkruante aq bukur në gegërisht po aq sa edhe në toskërisht. Gjuha e këtij shkrimtari është mjaft interesante dhe kërkon hulumtime të thelluara.

Do të kishin vend këtu edhe fjalët e albanologut V. Friedman, i cili shkruan se “nëqoftë se e lëmë mënjane politikën dhe mendojmë vetëm për estetikën dhe shkencën, tradita e pasur e dy dialekteve të gjuhës shqipe ka një vend në kulturën e botës”¹⁵.

Bibliografi e shfrytëzuar

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 2002.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Dialektologjia shqiptare*, VI, Tiranë, 1990.
- Altimari, F., “Il “futuro necessitativo” dell’albanese d’Italia”, në *L’influsso dell’italiano sulla grammatica delle lingue minoritarie*, Atti del Convegno Internazionale, Costanza, 8-11 ottobre, 2003
- Camaj, M., *Albanian grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden, 1984.
- Çeliku, M., *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2006.
- Demiraj, Sh., “Gjuha letrare e njësuar dhe çështja e paskajores”, Konferenca shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, Tiranë, 20-21 nëntor 1992, botuar më 2002, f. 56-60.
- Dhimo, A., *Për shqipen dhe shqiptarët I*, Tiranë, 2008.
- Ismajli, R., *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë, 2005.
- Ismajli, R., “Përtej alternativës infinitiv apo status minoritar”, *Studime* 8-9, Prishtinë, 2001-2002, f. 41-65.
- Likaj, E., *Format analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997.
- Mansaku, S., “Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj”, *Studime filologjike*, nr. 1, Tiranë, 1982, f. 139-163.
- Mansaku, S., “Funksionet sintakore të paskajores tek autorët e vjetër”, *Studime filologjike*, nr. 2, Tiranë, 1983, f. 99-112.
- Manzini, R. M. - L. M. Savoia, “Pjesorja dhe paskajorja në të folmen e Shkodrës”, *Studime filologjike*, nr. 3-4, Tiranë, 2003.
- Martin Camaj, *Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994.
- Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë, 2003.

LETËRSI E VJELË

¹⁵ V. Friedman, “Shqipja standarde në Amerikë: studime shkencore, pedagogjike dhe planifikimi gjuhësor”, *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë, 2003, f. 157.

MIMOZA PRIKU

- Camaj, M., *Rrathë*, München, 1978.
Camaj, M., *Dranja*, Roma, 1981.
Camaj, M., *Karpa*, Roma, 1987.
Camaj, M., *Vepra 4, 5*, Tiranë, 1996.